



**FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS
DEGA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE KARRIERËS**

RAPORT VJETOR 2020-2021

I. PËRSHKRIM I NJSBCZHK.

Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN) u krijua në Shkurt të vitit 2020. Sipas përcaktimit në ligjin për arsimin e lartë 80/2015, statutin e Universitetit të Tiranës dhe rregullores së posaçme për sigurimin e cilësisë, dega është një *strukturë ndihmësakadematike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e njësisë kryesore*. Kjo degë është në varësi të Dekanit të FSHN dhe aktualisht operon me një punonjës me kohë të plotë.

Vlen të përmendet që, veprimtaritë e rregulluara për DSBCK, përpara periudhës së krijimit si strukturë më vete, janë zhvilluar nga struktura ekzistuese, në respektim të të gjithë kërkesave ligjore, që lidhen me sigurimin e cilësisë dhe këshillimin e karrierës.

Në veprimtarinë e saj DSBCK, zbaton “Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës”, mbështetur njëkohësisht në “Manualin e Cilësisë” dhe “Paketën e Instrumentave të Cilësisë”, miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23 Dhjetor 2020. Instrumentat e përdorur përpara miratimit të paketës së instrumentave nga Rektorati, janë mbështetur në praktikat e universiteteve më prestigjioze në botë, që kryesojnë listat e rankimeve në rang ndërkombëtar.

DSBCK vlerëson në mënyrë periodike efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore ose artistike, si dhe efikasitetin e veprimtarive administrative të institucionit.

Në varësi të vlerësimit dhe monitorimit, çdo raportim që lidhet me Fakultetin i vihen në dispozicion Dekanatit dhe Drejtuesëve të Njësisë Bazë.

Raporti vjetor i njësisë dhe tërësia e veprimtarisë (dokumenta, raporte, etj) dorëzohet tek Dekani në fund të vitit akademik.

II. METODOLOGJIA E PUNËS

Metodologjia e punës së kësaj beqe është e bazuar në: Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë, Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Paketën e Instrumentave; Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu X “Sigurimi i Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Neni 103 “Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë”, Statutin e Universitetit të Tiranës, Kreu X “Sigurimi i Cilësisë”, Neni 138 “Sigurimi i brendshëm i Cilësisë në UT” si dhe Neni 139 “Parimet e funksionimit të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë”, si dhe dhe të gjitha dokumentet e ASCAL-it.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka në vëmendje parësore, sigurimin e cilësisë, ndaj operon për ritjen e saj në bashkëpunim me DSBCK.

1. Në fillim të vitit akademik, DSBCK ka paraqitur në Dekanat planveprimin e kësaj zyre, i cili është hartuar në bazë të politikave dhe strategjive institucionale për zhvillimin, përmirësimin dhe ruajtjen e standarteve.
2. Planveprimi është i përbërë nga rubrika të shtrira në periudha të ndryshme të vitit akademik 2020-2021, sipas kalendarit të po të këtij viti. Hartimi i këtyre rubrikave ka si qëllim sigurimin e cilësisë dhe ruajtjen e standarteve sipas udhëzimeve të ASCAL. Plan veprimi i miratuar nga Dekani ndiqet me rigorozitet nga DSBCK në drejtim të: mësimdhënies, studentëve, cilësisë, dokumenteve dhe kërkimit shkencor.
3. Duke qenë se mësimi është zhvilluar online këtë vit, edhe monitorimet apo të gjitha veprimtaritë janë kryer online.
4. Pas çdo procesi të planveprimit, DSBCK dorëzon në Dekanat, raportet e nxjerra nga monitorimet, vlerësimet, apo veprimtaritë e tjera. Në fund të vitit akademik, së bashku me raportet e çdo procesi, DSBCK dorëzon edhe raportin vjetor në Dekanat.
5. Të gjitha monitorimet, vlerësimet dhe aktivitetet e kësaj njësie ruhen në dosje të veçantë në DSBCK për vitin akademik 2020-2021.
6. Në proceset e vazhdueshme të kësaj njësie janë përfshirë të gjithë anëtarët e DSBCK të caktuar në organigramën e miratuar.
7. DSBCK ka operuar në mënyrë të pavarur për vlerësimin dhe monitorimin e proceseve të ndryshme dhe ka respektuar vetëm detajet e miratuara në planveprimin e miratuar nga Dekani.
8. Dekanati dhe Drejtuesit e njësive bazë janë vënë në dijeni me email përpara çdo fillimi të proceseve të ndryshme të punës së DSBCK, duke kërkuar mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e tyre që çdo anëtar të marrë të dhënat e nevojshme sipas rastit që është vlerësuar.

III. VEPRIMTARITË E KRYERA DHE AKTIVITETET E VLERËSUARA NGA DSBCK PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021

- U hartua modeli i syllabusit të lëndës sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018.
- Janë grumbulluar folderat me Planet Mësimore të çdo departamenti për vitet Akadematike 2020-2021.
- Janë grumbulluar folderat me syllabuset e çdo departamenti për vitin Akademik 2020-2021.
- Në fillim vitit akademik, DSBCK ka zhvilluar takime, këtë vit online, për mënyrën e monitorimit dhe raportimit të çdo procesi. DSBCK ka detyrimin që të bëjnë raport me shkrim për çdo proces monitorimi apo vlerësimi. Këto takime kanë pasur si qëllim trajnimin e anëtarëve për mënyrat e monitorimeve për procese të ndryshëm si dhe shpërndarjen e model raporteve të përbashkët.

- Gjatë vitit akademik 2020-2021 DSBCCK, në kuadër të akreditimit të programeve të studimit dhe ruajtjes së nivelit të cilësisë, të zhvillimeve në kuadrin ligjor si dhe garantimin nga ana e institucionit të nivelit të kërkuar për standartet e stafit akademik, janë organizuar trajnime të të gjithë stafit akademik dhe atij administrativ, ku DSBCCK ka dhënë një kontribut të rëndësishëm.
- Në fund të çdo semestri, përpara sezonit të provimeve, janë zhvilluar pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.
- Për vitin akademik 2020-2021 pyetësorët për cilësinë e mësimdhënies u orientua drejtë mësimi online, për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme, shkaktuar nga pandemia Covid-19.
- Për semestrin e parë dhe të dytë të këtij viti akademik (2020-2021), përpara sezonit të provimeve u shpallën pyetësorët e rradhës për **cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi për studentet**. Raporti i gjeneruar u përcoll pranë Dekanatit
- Në përfundimin e semestrit të parë u zhvillua **vlerësimi i lëndës nga secili pedagog**, u hartua raporti dhe rezultatet u përcollen në Dekanat menjëherë pas gjenerimit të raportit.
- Në fund të semestrit të dytë para provimit të diplomimit u shpallën pyetësoret **Raport i studentëve dhe Vlerësimi i studentëve që diplomohen**. Raportet e gjeneruara u përcollen në Dekanat.
- Ka vazhduar puna për përgatitjen e **paketës së vetëvlerësimit institucional** të FSHN. Nisur nga lista e informacioneve dhe të dhëna të nevojshme për akreditimin e programeve të studimit, bazuar në “Kodin e Cilësisë” dhe “Manualin për procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit”, konkretisht të dhëna cilësore dhe sasiore, janë përgatitur formatet e raportimit, për të koordinuar punën, sa i takon secilës fushë të veprimtarisë së fakultetit (sekretaritet mësimorë, departamentet, njësia e burimeve njerëzore, njësia e financës, administratori). Kryetari i degës do të ofrojë asistencë maksimale për të gjithë ekipin që po punon për sigurimin e informacionit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë të njësisë kryesore në përgatitjen e raportit të vlerësimit të brendshëm.
- Dega është kujdesur duke zhvilluar fushata ndërgjegjësimi për rëndësinë e sigurimit dhe përmirësimit afatgjatë të cilësisë.
- Sipas nevojave përcaktuar nga takimet me studentët dhe përfundimet e pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë janë organizuar trajnime me studentët.
- DSBCCK është kujdesur që përgjatë të gjithë kohës të ketë një bashkëpunim maksimal me Kujdestarin e Studentëve për evidentimin, adresimin dhe zgjidhjen e ankesave të studentëve.
- Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kreu IV, neni 32, pika 1 dhe 2, në të cilin cilësohet se, “Institucionet e arsimit të lartë paraqesin, për çdo vit akademik, pranë ministries përgjegjëse, raportet vjetore për veprimtarinë e kryer, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifën e shkolimit për vitin në vijim, informacion për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për

*secalin program studimi që ato ofrojnë, si dhe elementë të tjera të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës. Afatet për raportim përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.”, si dhe mbështetur në Udhëzimin Nr.5 datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të Istitucioneve të Arsimit të Lartë ” pasuar nga Udhëzimi Nr. 24, datë 21.10.2019 “Për një ndryshim në Udhëzimin Nr.5 datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të Istitucioneve të Arsimit të Lartë ”, u hartua **raporti vjetor për veprimtarinë akademike dhe administrative të FSHN** për vitin akademik 2020-2021, periudhë raportimi që sipas Urdhrit nr.330 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, datë 07.06.2019, “Për caktimin e datës së fillimit të vitit akademik 2020-2021 në institucionet e arsimit të lartë”, mbuloi shtrirjen kohore nga 1 Tetor 2020 deri më 30 Shtator 2021.*

- Ka vazhduar vlerësimi për ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga njësia kryesore, DSBCK, në bashkëpunim me Zv.Dekanin për Ciklin e Parë dhe të Dytë të FSHN-Së, përgatiti programin për **gjurmimin e studentëve** të diplomuar si dhe formulari për informacionin që do të mblidhet në funksion të gjurmimit, në përputhje me Rekomandimin (2017/C 423/01) e Këshillit Europian si dhe Guidës së BE-së për llojin e informacionit që duhet mbledhur për gjurmimin e studenteve. Ky formular gjendet në sekretariatë mësimore të të dy cikleve, zyrën e Këshillit Studentor si dhe sportelin e Informacionit të FSHN-së duke ju kërkuar studentëve që diplomohen apo atyre që janë diplomuar dhe paraqiten pranë Fakultetit për çështje të ndryshme dokumentimi, të plotësojnë dhe dorëzojnë vetëm një kopje për student. Të dhënat për këtë gjurmim po mblidhen dhe ruhen në një databazë të posaçme, për t’u përpunuar në përfundim të vitit akademik.
- Për sa i takon sektorit të karrierës është propozuar “Kalendari i aktiviteteve ekstrakurrikulare të FSHN” që pritet të vihet në zbatim sapo të normalizohet jeta studentore. Ky kalendar parashikon të ofrojë udhëzim për përgatitjen për tregun e punës, mundësi për vijim e studimeve, aplikim për bursa apo mundësi punësimi. Pavarësisht kësaj, studentet janë udhëzuar nga zyra e informacionit dhe kryetari i këshillit studentor, të kontaktojnë për këshillime për karrierë zyrën, në mënyrë elektronike. Në vijim të kësaj, është ofruar asistencë individuale për çdo student që i është afruar zyrës, për kërkesa për punësim që ka patur nga punëdhënës, për programe Erasmus, deri në asistencën për përgatitjen e dokumentave të nevojshme për aplikim për bursa studimi, gjenerim të shpejtë të dokumentave nga sekretariatë mësimore, me qëllim kapjen e afateve të aplikimit, asistencë në informimin për studime dhe praktika profesionale. Duhet konsideruar se, qëllimi fillestar i zyrës së karrierës pranë një institucioni të arsimit të lartë, është ofrimi i këshillimit për studente në fazën e përzgjedhjes së degës që do t’i përshtatej më tepër, kjo nga performanca e treguar në vitet e edukimit parauniversitar, interesin dhe preferencën përkatëse, talentin dhe pasionin, disponimin dhe sigurisht mundësitë për punësim pas diplomimit. Për fazën pas diplomimit, këshillimi i karrierës merr një trajtë tjetër. Dëshiroj të sjellë në vëmendje se, të gjithë programet e studimit ofrohen si pasojë e studimit të tregut të punës, studim që FSHN e kryen dhe aktualisht po azhurnohet për këtë vit, pa anashkaluar nevojën për kultivim të talenteve dhe mbështetjen e pasioneve të të rinjve. Planet mësimore (syllabus-et) axhornohen çdo vit, në masën 20%, për të qenë sa më bashkëkohore në raport me tregun e punës. Pra, nga pikepamja akademike-institucionale, studentët dalin të përgatitur për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës.

- DSBCK ka një bashkëpunim të vazhdueshëm me Këshillin Studentor. Pjesë e mirë e njoftimeve për pjesëmarrje studentore, njoftohet nga ky organ. Alumni i FSHN, zgjerohet çdo ditë, në sajë të bashkëpunimit me këshillin, programit për gjurmimin e studenteve por dhe kontakteve të vetë pedagogeve me ish studentë të FSHN, përmes leksioneve të hapura, për të ofruar mundësi për të ndarë eksperiencat më të vyera të tyre, që mund t’u shërbëjnë studenteve aktual. Një linjë tjetër për ruajtjen e kontaktit me alumnit është komunikimi me punëdhënës që kanë punësuar student të FSHN dhe që afrohen pranë fakulteti për të tërhequr me mundësi punësimi për student performues, duke zgjeruar kështu rrjetin e studenterve nxjerrë nga ky universitet. Kjo vjen dhe nga një praktikë tjetër e fakultetit që lidhet me formimin e vazhdueshëm (Long Life Learning). Nuk ka një normative që t’u imponohet pedagogëve apo studentëve për të kanalizuar formimin e tyre në LLL, por pedagogët çdo vit raportojnë mbi këto veprimtari dhe vërehet që është një nxitje e diktuar nga zhvillimet e tregut të punës dhe teknologjisë, dhe për pasojë kjo reflekton në mundësitë që i parashtohen studenteve, për të bërë më të mirën në përmirësimin e dijeve të tyre.
- Informimi i komunitetit akademik dhe i publikut për cilësinë e FSHN, bazohet në “*Manualin e Cilësisë*” së UT dhe kryhet përmes publikimit në faqen zyrtare të internetit të fakultetit. Për të dhënat sensitive, ato u komunikohen nga niveli i lartë i drejtimit të fakultetit, njësisive bazë, pedagogëve ose studentëve, në një praktikë jo për audience të gjerë.
- Komunikimet e brendshme të zyrës me të gjithë strukturën e FSHN zhvillohen nëpërmjet adresave të brendshme të email. Databaza e informacionit të degës për vlerësime dhe monitorime të brendshme është krijuar, azhurnohet dhe ruhet në sistemin online të FSHN, në bashkëpunim me zyrën e IT. Ndërkohë informacioni prodhuar nga DSBCK protokollohet dhe arkivohet në mbështetje të ligji 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.
- DSBCK, ruan kontakte të vazhdueshme me Njesi të tjera të të njëjtit profil, brenda dhe jashtë UT, me qëllim azhurnimin me praktikat më të mira të sigurimit të cilësisë në vend dhe këmbimin e eksperiencave. Ndjek në mënyrë të vazhdueshme publikimet e ASCAL mbi programe studimi apo institucione të akredituara, për të siguruar një model praktike akreditimi, për përgatitjen e një pakete të konsoliduar të vlerësimit të brendshëm. Njësia është në dispozicion të bashkëpunimit me NJSC-në e UT-së për vlerësimin e brendshëm të njësisë kryesore dhe akreditimin institucional dhe të programeve, në rastin e fillimit të procesit të akreditimit.

Degës së Sigurimit të Brendshëm

të Cilësisë dhe Karrierës, FSHN, UT